REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 59/17, 65/17
Datë/Datum. 07.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 59/17
65/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "AR TECH Sh. p. k"- Prishtinë, dhe OE "NPSH Electronik Business- PRO"- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull: "Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik", me nr prok: "16/395/521", i iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh. a)/, më datën 03. 04. 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "AR TECH Sh. p. k" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull "Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik", me nr prok:''16/395/521", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/.

II. **Aprovohet,** pjesërisht e bazuar ankesa e OE "NPSH Electronik Business- PRO"- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull "Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik", me nr prok: ''16/395/521", i iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/.

III. **Anulohet,** vendimi i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës/, për anulim të aktivitet të prokurimit, me titull "Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik", me nr prok:''16/395/521" dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

IV. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

V. Operatorëve ekonomik ankues OE "AR TECH" Sh. p. k - Prishtinë, dhe OE NPSH "Electronik Business-PRO"-Prishtinë, ju kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 28. 10. 2016. Hapja e ofertave është bërë me dt: 17. 11. 2016, ku kanë marr pjesë katër (4) operatorë ekonomik. Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm "Electronik Business-Pro" është bërë me datën 11. 01. 2017. Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm "Ar Tech Shpk" është bërë me datën 15.02.2017. Njoftimi për anulim të aktivitet është bërë me datën 27. 02. 2017.

Kundër njoftimit për anulim, operatori ekonomik "NPSH Electronik Business-PRO" Prishtinë, me dt: 21. 02. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 23. 02. 2017, autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NPSH Electronik Business-PRO"- Prishtinë.

Kundër njoftimit për anulim, operatori ekonomik "Ar Tech Shpk"- Prishtinë, me dt: 21. 02. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 23. 02. 2017, autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ar Tech Shpk"- Prishtinë.

Operatori ekonomik AR TECH" Sh. p. k - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 28 shkurt 2017 me nr. 59/17, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik", me nr prok: ''16/395/521", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi i Ligjit
- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti/Efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim/ Jo diskriminim
- Neni 28 i LPP-së – Specifikimet teknike
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 69 i LPP-së –Aftësia teknike dhe/ose Profesionale

Operatori ekonomik NPSH "Electronik Business-PRO"- Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 06 mars 2017 me nr. 65/17, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull: "Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyesve termik", me nr prok:''16/395/521", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së:

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi i Ligjit
- Neni 6 i LPP-së –Ekonomiciteti/Efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim/ Jo diskriminim
- Neni 10 i LPP-së – Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 62 i LPP-së – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik përmes raportit të datës 28 shkurt 2017, ka sqaruar që Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i sipërfaqeve të këmbyese termik" me nr prok: 16/395/521, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, prandaj i njëjti i ka rekomanduar panelit shqyrtues që këtë aktivitet të prokurimit të kthej në RI-VLERËSIM, ndërsa ankesën e OE"AR-TECH" Sh. p. k, të aprovojë si të bazuar, ndërkaq ankesën e "Electronik Business-PRO" ta aprovoj si pjesërisht të bazuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03. 04. 2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 28.1, kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues dhe eksperti shqyrtues e ai teknik, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: "*Për këto ankesa pas autorizimit për shqyrtim kam parashtruar kërkesë për ekspert tjetër – teknik, pasi që kryesisht pretendimet ankimore kanë pas të bëjnë me çështje profesionale. Të njëjtën kërkesë e kam mbështetur edhe për shkak të ngarkesës në punë atëherë. Në cilësi të ekspertit shqyrtues në raport kam potencuar që gjitha pretendimet ankimore janë trajtuar nga eksperti teknik, pasi që i njëjti të gjitha shkresat deri në datën e dorëzimit- protokolimit të raportit i ka pas në posedim. Pas përgjigjes së parashtruesit të ankesës OE "Elektronik Business Pro" ku kam pranuar si shkresë elektronike edhe unë si ekspert shqyrtues i lëndës, konkretisht kam kuptuar që njëri nga pretendimet e përfshira në ankesën e njëjtit ankues që lidhen me validitetin e ankesave nuk është trajtuar përmes raportit tonë të ekspertizës. Me gjithë atë pas përgjigjes së OE ankues pas pranimit të ekspertizës, e kam shqyrtuar pretendimin duke analizuar shkresat e lëndës, dhe të njëjtin pretendim e kualifikoj si të bazuar, pasi që AK-KEK procesin e vlerësimit të ofertave e ka përfunduar brenda afatit të validitetit të ofertave që parashihet në nenin 31.4 të UOPP-së. Me gjithë atë njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit është publikuar pas skadimit të validitetit të ofertave. Sipas shkresave të lëndës nuk kemi hasur në ndonjë shkresë- dëshmi ku është kërkuar nga ana e AK-KEK vazhdimi i validitetit të ofertave drejtuar OE-ve. Rrjedhimisht veprimi tillë paraqet mos respektim të vendimit të OSHP-së nr. 884/14, për njohjen e obligimit ligjorë për validititet*".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues teknik ka deklaruar: "*Pretendim kryesor dhe i vetëm i OE ankues Ar Tech, ka të bëjë me arsyetimin e eliminimit të potencuar në letër standarde, ku AK-KEK ka potencuar se numri punëtorëve që posedojnë certifikatën për punë në lartësi është shumë i vogël, 5 punëtor, krahasuar me vëllimin e punëve dhe periudhën prej 18 ditëve, duke potencuar se është e pamundur që me këtë numër të punëtorëve të kryhen punë kualitative. Një ndër arsyet e eliminimit është edhe pretendim i OE ankues "Elektronik Business Pro" , ku t njëjtin pretendim e kemi kualifikuar si të bazuar, pasi që AK –KEK në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale nuk ka specifikuar numrin e punëtorëve të certifikuar për punë në lartësi, por ka kërkuar listën e personelit teknik që do të angazhohen në realizimin e projektit. Që dy OE-të ankues posedojnë listën e stafit me apo personelit teknike, dhe rrjedhimisht plotësojnë kërkesën sa i përket punëtorëve. Pretendime tjera të OE "Elektronik Business Pro" është pretendimi që lidhet me kapacitetin teknik-profesional, ku AK-KEK ka kërkuar dy referenca për përfundim të punëve të natyrës së ngjashme. Gjatë shqyrtimit të ofertës së OE kemi has se i njëjti posedon vetëm një referencë të natyrës që AK ka kërkuar. Po ashtu arsye e eliminimit është edhe certifikata PED 97/23 EC, ku AK-KEK përmes dosjes së tenderit këtë certifikatë e ka kërkuar për*

kryerjen e punëve enë nën presion. Ndërsa OE "Elktronik Business Pro" të njëjtën certifikatë sipas përshkrimit në të njëjtën certifikatë përshkruhet se është për saldim. Njëjtat pretendime i kemi kualifikuar si të pabazuara. I njëjti OE po ashtu pretendim ankimor ka edhe për shkelje të nenit 10 të LPP-së, ku sipas shkresave të lëndës OE Elektronik Business Pro ka kërkuar qasje në dokumentacion, ndërsa AK-KEK i është përgjigjur duke i mundësuar qasje vetëm në ofertën e tij dhe jo edhe në ofertat e tjera. Andaj kemi propozuar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim, ankesa e OE Artech shpk të aprovohet si e bazuar, ndërsa ankesa e OE Elektronik Business Pro të aprovohet si pjesërisht e bazuar".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të fakteve dhe provave të ofruara në shkresat e lëndës, raportit të ekspertëve të OSHP-së, konstatoj se arsyetimi i autoritetit kontraktues në letrën standarde se OE "AR Tech" ka ofruar numër të pa mjaftueshëm të punëtorëve për punë në lartësi, është i paqëndrueshëm, kjo për faktin se OE ankues në fjalë ka prezantuar listën e punëtorëve ku janë të përshkruar mbi 20 punëtorë, ku në mesin e tyre janë rezultuar të jenë 5 punëtorë të certifikuar për punë në lartësi. OE ankues ka prezantuar metodologjinë e punimeve për punimin e pastrimit të sipërfaqeve ngrohëse në kaldaja të avullit A3, A4, A5. Paneli shqyrtues ka konstatuar se AK- KEK sh. a në dosjen e tenderit konkretisht tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale nuk e ka specifikuar numrin e punëtorëve të certifikuar për punë në lartësi.

Gjithashtu paneli shqyrtues ka konstatuar se është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues "Electronik Business Pro" se të njëjtit kanë plotësuar nenin 9. 1 të dosjes së tenderit- kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pasiqë në dosje të tenderit kanë ofruar listën e stafit posedon listën e stafit me personel teknik dhe plotësojnë kërkesën e numrit të punëtorëve duke ofruar 20 punëtorë, prej të cilëve 4 punëtor janë të certifikuar për punë në lartësi. Poashtu OE "Electronik Business Pro", ka kërkuar qasje në shkresat e lëndës, ndërkaq AK- KEK sh. a përmes shkresës elektronike i është përgjigjur të njëjtit duke i mundësuar qasje vetëm në ofertën e tij e jo edhe në ofertat tjera, dhe në këtë rast AK- KEK sh. a, ka shkelur nenin 10 të LPP-së- Mjetet për promovimin e Transparencës.

Paneli shqyrtues ka konstatuar se OE ankues "Electronik Business Pro", nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit *"minimum dy referenca për ekzekutim të mirë të punëve të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit 2013-2014-2015, në vlerë jo më pak se 70, 000, 00 euro"* pasiqë OE në fjalë ka ofruar vetëm një referencë të natyrës së njëjtë, ndërsa referencën e ofruar me titull: "Sanimi i sipërfaqeve të konstruksionit prej betoni të admiruar të kullës ftohëse në bllokun A4" paneli shqyrtues e ka konsideruar si jo të natyrës së ngjashme të kërkuar sipas dosjes së tenderit, andaj duke u bazuar ne këtë fakt, paneli ka konstatuar se ankesa e OE "Electronik Business Pro", është pjesërisht e bazuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

z. Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Korporata Energjetike e Kosovës"

1x1 OE – "AR TECH" Sh. p. k - Prishtinë

1x1 OE - NPSH "Electronik Business-PRO" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.